



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “Për miratimin e Shërbimit E-Buses, përcaktimin e intererave, stacioneve dhe çmimit të biletës, si shërbim plotësues i transportit qytetas

”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, , neni 23 pika 6, si dhe të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, nenet 10, 12 dhe 14

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bashkia Berat është përfituese e projektit “Pajisje për mbështetjen e shërbimeve bashkiake për përmirësimin e menaxhimit të trafikut”, një iniciativë e rëndësishme që synon rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe përmirësimin e mobilitetit urban. Projekti është financuar nga Banka Botërore dhe Komisioni Europian dhe zbatohet në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Në kuadër të këtij projekti, Bashkia Berat ka përfituar tre (3) autobusë elektrikë, të pajisur me tre (3) stacione karikimi, të cilët synojnë të përmirësojnë aksesin në zonat me interes historik dhe kulturor, veçanërisht në zonën e Kalasë.

Situata financiare :

5.1.1 Kosto e personelit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kostoja e personelit është llogaritur mbi bazën e një strukture funksionale të nevojshme për garantimin e vijueshmërisë së shërbimit gjatë gjithë vitit, e përbërë nga 10 shoferë, 1 përgjegjës dhe 1 dispeçer.

Numri i shoferëve është përcaktuar duke marrë në konsideratë organizimin e shërbimit në turne, oraret e zgjatura të funksionimit, si dhe nevojën për mbulim të ditëve të pushimit, lejeve vjetore dhe festave zyrtare. Në këtë kuadër, kostoja e personelit përbën një nga zërat kryesorë të shpenzimeve operative.

5.1.2 Kosto e energjisë elektrike

Kostoja e energjisë elektrike është vlerësuar duke u bazuar në karakteristikat teknike të mjeteve elektrike dhe në distancat e përshkuara gjatë operimit të përditshëm të shërbimit. Përdorimi i autobusëve elektrikë sjell avantazhe të rëndësishme në uljen e ndotjes dhe kostove krahasuar me mjetet tradicionale, duke kontribuar në një model transporti më të qëndrueshëm.

5.1.3 Kosto e mirëmbajtjes dhe sigurimeve

Shpenzimet për mirëmbajtje dhe sigurime janë vlerësuar mbi bazën e praktikave standarde për mjete të këtij lloji, duke përfshirë shërbimet periodike, kontrollin teknik dhe sigurimet e detyrueshme. Këto kosto janë të domosdoshme për garantimin e sigurisë dhe funksionimit optimal të shërbimit.

5.1.4 Kosto e amortizimit

Amortizimi është llogaritur duke marrë në konsideratë vlerën e investimit dhe jetëgjatësinë ekonomike të mjeteve, në përputhje me praktikën fiskale për asetet e transportit. Ky zë përfaqëson konsumimin gradual të vlerës së mjeteve në kohë.

5.1.5 Kosto të tjera operative

Përveç zërave kryesorë, në analizë janë marrë në konsideratë edhe kosto të tjera operative të nevojshme për garantimin e funksionimit të rregullt të shërbimit dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Këto përfshijnë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

• shpenzimet për prodhimin dhe furnizimin me bileta të printuara nga subjekte të autorizuar;

- shpenzimet për pajisje pune dhe elementë identifikues për personelin (si uniforma, jelekë etj.);
- kostot për sigurimin e mjeteve, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;
- shpenzimet për regjistrimin, qarkullimin dhe kontrollin teknik të mjeteve, përfshirë taksat dhe tarifatat përkatëse;
- si dhe kosto të tjera administrative dhe logjistike të lidhura me funksionimin e përditshëm të shërbimit.

Këto shpenzime janë vlerësuar në mënyrë të përgjithshme dhe janë përfshirë në analizën e kostove operative, duke reflektuar natyrën e shërbimit si një shërbim publik i organizuar dhe i standardizuar.

Në rast se për disa prej këtyre zërave parashikohet mbështetje nga projekti donator gjatë fazës fillestare të operimit, ndikimi i tyre në kostot totale do të jetë i reduktuar.

5.1.6 Përmbledhje e kostove

Në tërësi, kostot e operimit të këtij shërbimi reflektojnë natyrën e tij si një shërbim publik modern dhe të qëndrueshëm, i cili kërkon një nivel të caktuar investimi për të garantuar cilësi dhe vazhdimësi.

Kosto totale të parashikuara : 25,533,164.28 leke me TVSH

Aneksi i Tabeles bashkangjitur shpjegon zërat e kostove.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

SHA "Berat City Green", Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve.

Impakti social / grupet që preken:

Qytetaret vendas dhe të huajqë do të përdorin transportin

A është objekt i konsultimit publik:

Po. Është objekt konsultimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 30 /03/2026, shqyrtoi projekt vendimin “Për miratimin e Shërbimit E-Buses,përcaktimin e intererave,stacioneve dhe çmimit të biletës,si shërbim plotësues i transportit qytetas”

relacionin e dokumentat shoqërues propozuar nga GRUPI I PUNES

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

1. Miratimin e shërbimit të transportit publik me autobusë elektrikë (e-buses), si shërbim plotësues me karakter turistik
2. Shërbimi do të kryhet nga shoqëria “Berat City Green” sh.a., në pronësi 100% të Bashkisë Berat, pasi të pajiset me licencën përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
3. Miratimin e itinerareve:
 - Qendër – Kala pa ndalesa dhe anasjelltas
 - Terminal – Kala pa ndalesa dhe anasjelltas
4. Miratimin e orareve të linjave dhe stacioneve për shërbimin E-Bus, sipas itinerareve dhe sezonit turistik:
 - **Itinerari 1:** Qendër – Kala pa ndalesa dhe anasjelltas, :
 - Muajt jashtë sezonit turistik (janar, shkurt, mars, nëntor, dhjetor): autobusët do të qarkullojnë çdo 60 minuta, nga ora 08:00 deri në orën 19:00.
 - Muajt e sezonit turistik (prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor): frekuenca e lëvizjes do të jetë çdo 30 minuta, me orar funksionimi nga ora 07:00 deri në orën 20:00.
 - **Itinerari 2 :** Terminal – Kala dhe anasjelltas, Pa Ndalesa :
 - Muajt jashtë sezonit turistik (janar, shkurt, mars, nëntor, dhjetor): autobusët do të qarkullojnë çdo 60 minuta, nga ora 08:00 deri në orën 19:00.
 - Muajt e sezonit turistik (prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor): frekuenca e lëvizjes do të mbetet çdo 60 minuta, me orar funksionimi të zgjatur nga ora 08:00 deri në orën 20:00.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. Miratimin e tarifës të biletës në vlerën 100 (njëqind) lekë për udhëtim.
6. Financimi i shërbimit do të realizohet nga të ardhurat e gjeneruara dhe, kur është e nevojshme, nga mbështetja buxhetore e Bashkisë Berat.

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 30 /03/2026